

EC Ma Ndryshe ka nisur zbatimin e pilot veprimit "HAJDE!", që synon promovimin e trashëgimisë kulturore, kultivimin e qytetarisë aktive në mesin e të rinjve dhe mbrojtjen/promovimin e vlerave të kulturës dhe trashëgimisë kulturore në Prizren. Aktiviteti qendror i "HAJDE!" do të jetë punëtorja pesë ditore e zejes së filigranit, për të cilën EC Ma Ndryshe shpall këtë:

## THIRRJE PËR APLIKIM

*Për pranimin e dymbëdhjetë të rinjve për punëtorinë e Filigranit  
24 – 28 shtator 2014, Prizren*

Angazhimi në punëtorinë pesë (5) ditore të zejes së Filigranit është një mundësi unike dhe atraktive për të rinjtë e shkollave të mesme dhe studentëve. **Përfitimet e të rinjve nga pjesëmarrja në këtë punëtori janë:**

- Mundësi për të mësuar zejen tradicionale të Filigranit nga profesionistët,
- Mundësi për të mësuar për trashëgiminë kulturore të rajonit të Prizrenit,
- Mundësi për të krijuar komunitet të të rinjve që kanë interes në trashëgiminë shpirtërore,
- Mundësi për të kaluar një javë sfiduese dhe argëtuese në qytetin e Prizrenit.

### ***Pjesëmarrja në punëtorinë e Filigranit nënkupton:***

- Punë praktike pesë ditore në punëtorinë e Filigranit, me orar 10:00 – 16:00,
- Angazhim dhe përkushtim ndaj punëtorisë,
- Pjesëmarrje në ligjëratat e punëtorisë,
- Krijimi i marrëdhënieve të mira njerëzore dhe kolegjiale me grupin dhe stafin e punëtorisë së Filigranit.

### ***Pjesëmarrësit duhet të jenë***

- Nxënës të shkollave të mesme, aktualisht duke i ndjekur vitet shkollore 12 dhe 13, studentë dhe të rinj të tjerë të interesuar në këtë zeje,
- Nxënës me sukses të mirë shkollor,
- Me përvojë në aktivitete vullnetare ose aktivitete të tjera jashtëkurrikulare,
- Të motivuar për të mësuar një zeje tradicionale,
- Të gatshëm për të ndjekur programin dhe për të punuar për pesë ditë radhazi në punëtorinë e Filigranit,
- Të aftë për të dëshmuar përfitimin nga ky angazhim.

***Për pjesëmarrësit jashtë Prizrenit, akomodimi, shpenzimet e udhëtimit dhe ushqimi janë të mbuluara nga organizatorët. Për pjesëmarrësit nga Prizrenit, mbulohen vetëm shpenzimet e domosdoshme gjatë kohës së punëtorisë.***

Për të aplikuar, ju lutem plotësoni formën e aplikimit që gjendet në web-faqen e organizatës [www.ecmandryshe.org](http://www.ecmandryshe.org), brenda linkut **Konkurs**. Formën e plotësuar duhet të dërgoni në adresën [info@ecmandryshe.org](mailto:info@ecmandryshe.org), me *subject* "Aplikim për punëtorinë HAJDE!". EC Ma Ndryshe rezervon të drejtën për të krijuar listën e ngushtë të aplikantëve, pas së cilës do të realizohen edhe intervistat. Në përzgjedhjen e pjesëmarrësve do të konsultohen edhe personeli mësimor i shkollave. Afati i fundit për aplikim është 14 shtator 2014.

*Pilot veprimi "HAJDE!" dhe punëtorja e Filigranit organizohen në kuadër të projektit të përbashkët BE/KE për Përkrahjen dhe Promovimin e Diversitetit Kulturor (PCDK)*